



# Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri

Gjetjet kryesore

## Gjetjet kryesore – karakteristikat demografike


- Një total prej 133.544 emigrant shqiptarë u kthyen gjatë periudhës 2009-2013, nga të cilët 74% ishin meshkuj
- Kthimet **vullnetare** – mbizotëruese (94.3%)
- **Mosha mesatare** në momentin e emigrimit ishte 30,7 vjeç dhe 38,3 në momentin e anketës






- Kthimet kanë qenë në rritje që prej vitit 2011
- Rritja e numrit të kthimeve ka ardhur si pasojë e kthimeve nga Greqia që kanë ndodhur më së shumti për shkak të krizës financiare në këtë vend dhe ndikimit të saj negativ në tregun e punës


- Greqia ka qenë vendi i fundit për shumicën e të kthyerve, dhe kohëzgjatja mesatare e qëndrimit – 7 vjet



Shumica e të kthyerve janë vendosur në vendin e tyre të lindjes ose në vendbanimin e zakonshëm




Numri më i madh i të kthyerve janë vendosur në **Tiranë**, megjithatë jo të gjitha qarqet preken njësoj nga migracioni i kthimit



# Arsyet e emigrimit (më shumë se 1 alternativë)

- Arsyet kryesore – ato **ekonomike**


- Papunësia
- Mundësi më të mira punësimi
- Të ardhura më të mira jashtë
- **Bashkim familjar**



# Gjendja martesore


Pas kthimit numri i të martuarve më i ulët sesa ai gjatë qëndrimit në vendin e fundit të emigrimit

- 30% e të kthyerve ka mbajtur gjendjen e tyre civile ‘beqar’ gjatë emigracionit dhe pas kthimit të tyre në Shqipëri.
- Rreth 23 për qind kane ndryshuar gjendjen e tyre martesore




# Përbërja familjare

- Kalimi nga një “familje e madhe” – para emigrimit - në një “familje me një bërthamë” – pas kthimit



## Situata e punësimit


- **Rënie** e numrit të të **papunëve** – para emigrimit krahasuar me atë në vendin e fundit të emigrimit – **Rritje** e saj – pas kthimit në Shqipëri
- **Rritje** e numrit të **vet-punësuarve** pas kthimit – kjo reflekton dhe faktin pse **përqindja e të papunëve** është **reduktuar** nëse shohim Statusin e punësimit fillestar pas kthimit dhe Statusin e punësimit në momentin e anketës






# Aktiviteti ekonomik

- **Sektorin e bujqësisë** vërehet një rritje nga 14.6% në 30.7% si dhe tregtia me pakicë nga 2,9% në 10,6% pas kthimit
- Pas kthimit - punësimi në **sektorin e ndërtimit** ulet në 22.6%
- **Sektori i turizmit** është i vetmi sektor ku punësimi jashtë vendit dhe në Shqipëri mbetet në nivele të qëndrueshme (12% dhe 11.3%)




## Niveli arsimor

- 49.1% kishin përfunduar **arsimin e mesëm** përpara se të largoheshin jashtë vendit;
- 37.0% kishin përfunduar **arsimin e lartë**;
- Një trend në rritje në përqindjen e atyre që kishin marrë një **diplomë universitare/master ose doktoraturën** në vendin e fundit të emigracionit 5.4%.




# Situata financiare (subjektive)

## Para emigrimit




## Në vendin e fundit të emigrimit



## Pas kthimit krahasuar me atë jashtë vendit


- Shumica e të kthyerve shohin situatën e tyre financiare **të pandryshuar** 41.3%;
- 38.8% e tyre kanë situatë financiare **më të rënduar** pas kthimit;
- Vetëm për 20% situata financiare është përmirësuar.



# Dërgesat në para (gjatë vitit të fundit të qëndrimit)

## Arsyet e dërgimit:


- 97% e të pyeturve dërgonin para për të plotësuar **nevojat e familjes**
- 29.3% për të ndërtuar ose blerë **shtëpi**
- 22.7% për të paguar **shkollimin e fëmijëve**




## Frekuenca e dërgesave

- Një herë në muaj
- Një herë në tre muaj
- Dy herë në vit
- Një herë në vit
- Sporadike
- Asnjëherë

## Shuma e dërguar




# Investimet



## 3 arsyt kryesore për mos ndërmarrjen e një investimi:

- **Kapitali i pamjaftueshëm**, që kufizon disponueshmërinë e burimeve financiare të nevojshme për të filluar një biznes;
- **Mungesa e ndonjë planifikimi** paraprak për të bërë ndonjë investim në Shqipëri;
- **Mungesa e përvojës** dhe trajnimit për investimin

## Burimi i financimit




## Problemet e hasura për ata që kanë investuar:

- Konkurrenca (52%)
- Kapitali i pamjaftueshëm (46%),
- Mungesa e përvojës (40.0%),
- Kufizimet administrative dhe sfidën menaxheriale (39%)

# Kontaktet dhe vizitat gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit


## Vizitat në Shqipëri



## Arsyet e vizitave në Shqipëri

- Shumica e migrantëve shqiptarë gjatë vitit të fundit të qëndrimit jashtë vendit, kanë udhëtuar për në vendin e tyre në raste **kryesisht sporadike** dhe të paplanifikuara;
- Udhëtimi për **punë** nuk ka qenë i shpeshtë;
- Udhëtimet për **festa** kanë ndodhur më së shumti **një herë në vit** ose në mënyrë **sporadike**

## Kontaktet me familjarët



## Konkluzione dhe rekomandime

- Të kthyerit i përkasin segmentit të **forcës më aktive të punës** (38 vjeç). Është e rëndësishme që të eksplorohet më tej ndikimi i kthimit mbi tregun e punës në Shqipëri, si edhe ndikimi i mundësisë së punësimit në vendimin për të qëndruar në Shqipëri ose për të ri-emigruar;
- Pas migracionit vërehet një rritje e punësimit në sektorin e bujqësisë. Kjo tregon që të kthyerit po investojnë në **bujqësi dhe në tregëtinë me pakicë**;
- Në terma investimi pas kthimit, vetëm 8 % e të kthyerve ka arritur të realizojë një projekt investimi. Arsyeja kryesore për mungesën e një projekti investimi është **kapitali i pamjaftueshëm** dhe prandaj shumica e të kthyerve të këtij segmenti të popullsisë kërkon lehtësimin e procedurave administrative të biznesit dhe përfitime tatimore/ulje taksash për të inkurajuar investimet nga të kthyerit

# Faleminderit për vëmendjen Tuaj!

**Emira Galanxhi**

Drejtoreshë e Statistikave Sociale, INSTAT

[egalanxhi@instat.gov.al](mailto:egalanxhi@instat.gov.al)